



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.05.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Diskutimi nen për nen i projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”
(komision përgjegjës).

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Ylli Fideli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Fadil Nasufi, Ismet Beqiraj, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Besnik Baraj (zëvendësues),

Mungojnë:

Adelina Rista, Ismet Beqiraj, Romeo Gurakuqi, Nora Malaj.

Të ftuar:

Oltjon Muzaka - sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës,

Sofjan Jaupaj – këshilltar ligjor i ministres së Kulturës,

Eris Hysi - avokate mbështetëse në Ministrinë e Kulturës,

Ekflooda Leskaj – këshilluese ligjore e Fondacionit Shqiptar-Amerikan për Zhvillim.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi - ...lloj-lloj gjërash për ta minuar. Sigurisht që e dinit ju. Ju kështu funksiononi. Ne kemi ardhur për mbledhje komisioni.

Të lutem, Fidel, mos ndërhy! Akoma nuk e kam hapur mbledhjen. Ke disa ditë që po bën zhurmuesin, Fidel.

Hapim mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sot kemi vijimin e diskutimit nën për nën të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, pavarësisht se ne ishim dakordësuar krejtësisht ndryshe. Ju edhe dje, në mënyrë të njëanshme, keni filluar të diskutoni nën për nën projektligjin, duke shkelur të gjitha marrëveshjet që kemi bërë në komision, si dhe vendimet e komisionit.

Siç e shihni, kemi prezencë shumë të madhe nga ana e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, sepse prej 1 jave nga Partia Demokratike kemi denoncuar disa fakte që janë tronditëse, fakte që janë rrëqethëse, skandaloze, për sa i përket vëllait të ministrit të Brendshëm Agron Xhafaj, i cili është kapur në një operacion ndërkombëtar të bashkëpunimit të policisë italiane dhe të DEA-s. Në fakt, për Agron Xhafajn ka një vendim të formës së prerë prej 7 vjetësh e 2 muajsh, por nuk e ka vuajtur as edhe një ditë të vetme dënimin.

Po ashtu, ditët e fundit nga Partia Demokratike kemi denoncuar faktin që ministri i Brendshëm për të mbrojtur vëllanë e tij, Agron Xhafajn, ka falsifikuar jo vetëm procesverbalet, por ka falsifikuar edhe ligjet e reformës në drejtësi. Për aq kohë sa ne jemi ligjvënës, atëherë çfarë reforme në drejtësi dhe çfarë ligjesh jemi duke diskutuar në këtë komision, kur ligjet jo vetëm që i shkelni, por edhe i falsifikoni në ndihmë të familjarëve, të cilët janë kapur nga policia italiane dhe nga DEA për trafik ndërkombëtar droge?!

Po ashtu, një fakt tjetër që është denoncuar jo më larg se dje, është që ministri i Brendshëm ka mbrojtur vëllanë e tij, i cili është në Shqipëri prej shumë kohësh, është i lirë dhe ka biznes. Jo vetëm kaq, por ai nuk ka ushtruar funksionin e tij si ministër i Brendshëm duke shkelur ligjet, për sa i përket ligjit Antimafia. Janë çështje për të cilat jo vetëm unë, por i gjithë publiku shqiptar është i tronditur, ndaj edhe një pjesë e mirë e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike janë sot prezent këtu për të shprehur edhe ata

mendimet rreth asaj çka ne, si ligjvënës, duhet të bëjmë në këtë komision. Përkundrazi, ju jo vetëm që nuk po e bëni, por po heshtni. Dhe heshtja juaj është ajo e cila e vret më shumë ligjshmërinë, kushtetutshmërinë dhe drejtësinë në Shqipëri.

Unë dua t'ia kaloj fjalën kryetarit të Grupit Parlamentar të PD-së, zotit Spaho.

Edmond Spaho - Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Kjo seancë e Komisionit të Medias, sigurisht, nuk është e zakonshme. Sikurse e shikoni ka një prezencë të shtuar të Grupit Parlamentar të PD-së dhe qëllimi është që të shprehim shqetësimin tonë për gjendjen në të cilën është vendi, posaçërisht Kuvendi i Shqipërisë. Prej më shumë se një jave, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, nëpërmjet një sërë konferencash shtypi, ka bërë publike fakte të rënda të përfshirjes së ministrit të Brendshëm dhe familjarëve të tij në organizata kriminale dhe trafikun e drogës. Dihet që vëllai i ministrit të Brendshëm është i dënuar me vendim të formës së prerë nga Gjykata e Kasacionit të Italisë dhe shkallët e tjera të gjyqësorit italian për pjesëmarrjen në organizata kriminale dhe trafikimin e drogës ndërmjet Europës dhe Shteteve të Bashkuara, madje operacioni është kryer me pjesëmarrjen e DEA-s amerikane. Do të duhej që ai të kryente dënimin, pavarësisht se është familjar i një ministri të një vendi anëtar të NATO-s, por, për fat të keq, ky individ për asnjë ditë nuk ka shlyer dënimin, madje ka ardhur në Shqipëri dhe është marrë në mbrojtje nga strukturat shtetërore. Ai ka ndërruar dhe emrin. Dhe sikur të kishte filluar një jetë të re, normale, sikurse e pretendoi ministri, meqenëse në Itali paska qenë në vendin dhe kohën e gabuar, në fakt ka vazhduar me të njëjtën praktikë, duke qenë pjesë e organizatave kriminale, të cilat veprojnë në territorin e Shqipërisë. Pra, moskryerja e dënimit, ndërrimi i emrit, ndryshimi i ligjeve të Republikës së Shqipërisë, për t'i dhënë atij mbrojtje politike dhe ligjore nga ana e ministrit të Brendshëm, në kohën kur drejtonte komisionin për reformën në...

Nuk po flas për dasmën e Skënderbeut.

Albana Vokshi – Fate, mos ndërhy! Merr fjalën dhe fol!

Edmond Spaho – Po flas për një çështje shumë të rëndësishme, e cila duhet të të shqetësojë ty si përfaqësues i këtij populli.

Albana Vokshi – Ju të Vlorës duhet të flisnit të parët, ndërsa ju heshtni. Çfarë po bëni? Lëreni kryetarin të flasë, pastaj merreni fjalën.

Edmond Spaho – Kam të drejtë të vij në komision dhe të flas për shqetësimet e mia.

Albana Vokshi – A ka mundësi të dëgjoni dhe më pas reagoni? Mos heshtni!

(Debate në sallë.)

Edmond Spaho – A ka mundësi të më lësh të mbaroj?

Albana Vokshi – Milva, për procedurë nuk ndërhyt dot. Ta mbarojë një herë kryetari, pastaj merre ti fjalën për procedurë.

Milva Ekonomi – Ne kemi një rend dite, për të cilin është rënë dakord dhe kjo nuk është në rendin e ditës. Në qoftë se duhet t'i bëni këto deklaratime, bëjini të enjten nga foltorja, jo nga komisioni. Komisioni ka tjetër rend dite. Ne kemi rënë dakord për rendin e ditës.

Edmond Spaho - Duhet të jeni mbrojtës të ligjit, të rregullit dhe rendit. Duhet të jeni të shqetësuar që Shqipëria nuk po hap dot negociatat, për shkak se është bërë simbol i krimit të organizuar dhe i trafikut të drogës. Në radhë të parë, duhet të jeni ju deputetët e Vlorës, pasi organizatat kriminale, të cilat kanë gjetur strehë në këtë qytet, duhet t'i luftojmë bashkërisht, në mënyrë që t'i hapim vendit rrugën për integrim europian. Nuk shkohet në Europë me kriminelë si doni të shkoni ju. Nuk shkohet me mbrojtje shtetërore të një qeverie narkotrafikantësh. Prandaj, mos më ndërprisni. Më lejoni të shpreh mendimin tim. Sot ky është një shqetësim i të gjithë qytetarëve shqiptarë. Nuk mund të kemi një ministër të Brendshëm që është i përzier në trafikun e drogës dhe në mbrojtjen e organizatave kriminale. Ju duhet të bashkoheni dhe të ngrini shqetësimin me ne. Ministri i Brendshëm duhet të japë dorëheqjen. Nuk kemi më kohë që të mbajmë si ministra të Brendshëm ata persona që janë lidhur me krimin e organizuar.

Prandaj nuk do të ketë punë normale të këtij parlamenti, nuk do të ketë punë normale në komisione, nuk do të ketë në seancë plenare, derisa ministri i Brendshëm të japë dorëheqjen dhe të largohet. Pavarësisht zhurmës që bëni ju këtu, ne jemi të vendosur, sepse jemi në anën e qytetarëve dhe të vendit. Derisa ministri i Brendshëm të japë dorëheqjen, nuk do të ketë seancë normale as në komisione, as në Kuvend, sepse ne jemi të vendosur mos ta lëmë qeverinë të jetë pasqyrë e organizatave kriminale. Të mos e

lëmë policinë të bëjë sehir dhe t'u shërbejë narkotrafikantëve, të mos e lëmë të shkojë të arrestojë qytetarët e Kukësit dhe të arrestojë ata të cilët nuk paguajnë energjinë elektrike, dhe të lërë Agron Xhafën të bredhë i lirë me emër të ndryshuar, të merret me trafikun e drogës, të shpërndajë licencat për të transportuar sot e për të transportuar nesër me gomone drogën në drejtim të Europës. Kjo nuk është sjellja e një vendi anëtar të NATO-s dhe nuk kemi për të hyrë në Europë në këtë mënyrë. Prandaj nuk do t'ju lejojmë, pavarësisht se jeni të instruktuar për të bërë zhurmuesin.

Milva Ekonomi – Ju nuk mund të deklaroni gjëra që akoma nuk i ka konkluduar gjykata dhe prokuroria. Mos keqinformoni publikun.

Edmond Spaho – Të lutem, Milva, se nuk je i atij takëmi që të mbrosh trafikantët e drogës.

Milva Ekonomi - Unë jam e takëmit që duhet të ndjekim rregullat. Nuk e dinim për këtë rend dite. Ky rend dite u bë i sforcuar.

Edmond Spaho – Të gjithë bashkë duhet të bëhemi një dhe të luftojmë bandat e drogës, të cilat kanë kapur qeverinë, kanë kapur Edi Ramën, kanë kapur ministrin e Brendshëm dhe të gjithë drejtuesit e rëndësishëm të këtij shteti.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Çfarë problemi keni me procedurën, Milva? Po flasim për një ligj. Ju ligjet i falsifikoni, ligjet që duhet t'u japin drejtësi qytetarëve, ju i falsifikoni në seancë plenare. Atëherë për çfarë gjëje tjetër duhet të flasim ne sot në komision? Si thua që nuk ka vendim gjykate! Është dënuar 7 vjet e 2 muaj me vendim të formës së prerë në gjykatë dhe nuk ekzekutohet. Çfarë vendimi doni tjetër ju? Atëherë do të flasim për ligjin.

Nëse do të flasim për trashëgiminë kulturore, për çfarë trashëgimie do të flasim? Për çfarë kujtese do të flasim? Ju, paratë e drogës që bën vëllai i ministrit të Brendshëm, do t'i përdorni për të ndërtuar kulla atje ku doni të shembni trashëgiminë kulturore. Kjo është lidhja. Nuk po e kuptoni? Për këtë do të flasim sot. Mos bëni zhurmuesin kot. Na lini të flasim. Në qoftë se e doni fjalën, kërkojeni. Do të vazhdojmë, sepse çdo deputet i Kuvendit ka të drejtë të jetë prezent në një mbledhje komisioni, ka të drejtë të marrë fjalën. Nuk ka të drejtë vote. Gjithsecili do të vijë këtu dhe do të flasë. Është e lidhur me trashëgiminë kulturore, është e lidhur me historinë, është e lidhur me kujtesën që ju doni

ta rrafshoni dhe t'i lini vetëm drogë dhe kriminalitet fëmijëve tanë. Çfarë po bëni? Mos heshtni, por flisni. Mos u bëni palë me krimin shtetëror. Këtë po kërkojmë sot.

Po, zoti Noka.

Flamur Noka - Faleminderit!

Unë e kuptoj shqetësimin për diskutimin e projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe për muzetë”, por, për fatin e keq të Shqipërisë dhe të shqiptarëve sot ka një trashëgimi tjetër, një trashëgimi që dorëzohet nga dora e Saimir Tahirit, krimi, droga dhe korrupsioni, te dora e Fatmir Xhafës, po droga, krimi dhe korrupsioni. Sot kjo është trashëgimia që shqetëson shqiptarët dhe çdokënd. Kjo shqetëson edhe faktorin ndërkombëtar. Sot Shqipëria nuk mund të përballojë më që të shkojë nga një ministër i Brendshëm i drogës te një ministër tjetër i Brendshëm i drogës dhe i trafikut.

Milva Ekonomi -Unë kam shumë respekt për fjalën tuaj, por besoj që i gjithë ky rend dite ka nevojë nga ana jonë që të marrim kohën e duhur për të reflektuar. Do t'ju kërkoja 5 minuta pushim... ... me grupin tonë dhe pastaj të kthehemi në sallë.

Flamur Noka - Sot shqiptarët kërkojnë në mënyrë urgjente largimin e Fatmir Xhafës, sepse ai nuk mund të përfaqësojë më verdiktin qytetar të luftës kundër drogës. Fatmir Xhafaj nuk mund të jetë më përfaqësues i qytetarëve, pasi është kapur në flagrancë. Në rast se ju kërkon ta diskutojmë ligjin nen për nen, po ju themi nen për nen se Agron Xhafaj është i kapur në një operacion ndërkombëtar si kapoja e një organizate kriminale të trafikut të drogës, operacion ky i zhvilluar nga DEA dhe nga policia italiane. Agron Xhafaj është i dënuar me 7 vjet dhe 2 muaj heqje lirie për pjesëmarrje në trafikun e drogës. Agron Xhafaj sot është i lirë dhe çdo ditë endet sa në Vlorë dhe sa në Tiranë. Sot Agron Xhafaj, megjithëse ka dënim të formës së prerë nga drejtësia italiane, ka një adresë, ka një numër telefoni dhe ka një vend ku zhvillon i lirë aktivitetin e tij të trafikut, sepse ka imunitetin politik për mbrojtje, e mbron ministri i Brendshëm, vëllai i tij. Sot Agron Xhafaj ka ndërruar emrin dhe qarkullon me një emër tjetër, ndaj dhe nuk është ekstraduar dhe nuk ka shkuar të vuajë dënimin. Kërkojmë që të largohet urgjentisht ministri i Brendshëm, pasi me imunitetin e tij politik, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ligjeve ka falsifikuar dhe ka manipuluar ligjin, për t'i dhënë mbrojtje dhe mbështetje vëllait të tij të dënuar në shtetin fqinj.

Ky vend nuk mund të pranojë më dhe nuk mund të vazhdojë më duke trashëguar ministrat trafikantë, të lidhur me drogën dhe ministra të Brendshëm të lidhur me krimin. Ky vend dhe shqiptaret nuk e meritojnë një turp të tillë që ua ka bërë peshqesh Edi Rama. Ka vetëm një zgjidhje që shqiptarëve t'u rikthehet dinjiteti i nëpërkëmbur nga Rilindja dhe qeveria e saj. Duhet pastruar një herë e mirë e gjithë kupola shtetërore dhe e gjithë administrata e shtetit nga njerëz të krimit dhe të lidhur me krimin. Në rast se duam që ky vend të bëhet, kjo duhet të fillojë urgjent dhe që të fillojë urgjent, ne duhet të japin shembull si politikanë që jemi, dhe shembulli duhet të fillojë nga ministri i Brendshëm. Fatmir Xhafaj, të vazhdojë me Kryeministrin dhe më të gjithë banditët e kriminelët e emëruar nga bandat në të gjithë hierarkinë e administratës shtetërore.

Faleminderit!

(Largohen deputetët e pozitës, pas kërkesës për një pushim të shkurtër.)

Albana Vokshi – Faleminderit!

Është për të ardhur keq që deputetët e maxhorancës së këtij komisioni bojkotojnë mbledhjen dhe kjo nuk është hera e parë, është e disataherë. Morën urdhër me SMS dhe filluan të flasin, tani morën urdhër ta lënë komisionin. Është ulëritës fakti që po bëhen palë me krimin, ndaj unë gjej rastin t'i ftoj të kthehen, të vazhdojmë mbledhjen.

Po, zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, e vërteta dhemb dhe zakonisht është e hidhur për atë që i përplasit në fytyrë. Edhe reagimi i deputetëve të maxhorancës është i natyrshëm, pasi kemi kohë që artikulojmë të vërteta të hidhura e të rënda dhe nuk kemi asnjë reagim, të paktën nga deputetët, nga qeveria dhe presim të kemi reagim nga opinionin publik, i cili është revoltuar. Them se e vërteta dhemb, pasi e shoh që kjo qeverisje ka humbur jo vetëm kredon morale, por nga sot ka humbur edhe kredon politike për të qeverisur vendin.

Sot kemi një ish-ministër i cili hetohet për afera droge. Kemi familjarët e ministrit, që janë përfshirë, janë të dënuar dhe këta vijnë këtu dhe bëjnë sikur bëjnë ligje, por ne jemi ligjvënës dhe nuk mund të bëjmë *show*. Këta njëkohësisht bëjnë ligje dhe i zbatojnë jo për veten e tyre, por kur kanë interes për klientelën e tyre dhe kur janë penalizuese, i shmangin nga vetja dhe nga familjarët.

Dje mësova që na është ngritur një padi nga këta që janë dënuar dhe janë akuzuar sot sipas shprehjes popullore “i shari të shan”, por që këta e kanë shndërruar “i akuzuari të akuzon”. Në fakt, akuzat ndaj kësaj maxhorance janë ulëritëse. Sot nuk kemi thjesht deputetë të përjashtuar, se janë ose ishin të përfshirë me krimin, por kemi qeveritarë të përfshirë në krim dhe shqetësimi ynë kryesor ka qenë se kjo maxhorancë është e kapur kokë e këmbë nga krimi dhe ne e kemi vërtetuar dhe e vërtetojmë çdo ditë, kurse këta shmangen dhe largohen, sepse kanë ndryshuar etalonin e ligjit. Sot ka një ligj antimafie, të mos bëjmë sikur jemi thjesht ligjvënës, sepse jemi subjekte të ligjit, sikurse është qytetari i thjeshtë, por ligji duhet të jetë i barabartë, si për deputetin, për qytetarin e thjeshtë, për ministrin dhe për Kryeministrin. Për qytetarët këta kanë ligj, kurse për vete kanë “maliqin” dhe ministri aktual nuk e zbaton ligjin Antimafia, sepse nuk i leverdis. Nuk e zbaton madje as Kryeministri e as prokuroria që ta marrë ministrin në fjalë të pandehur për shkeljen dhe ndryshimin absurd që ka bërë në ligjet kushtetuese të reformës në drejtësi. Përkundër kësaj, vazhdohet që ligji të jetë i ashpër ndaj njerëzve të thjeshtë që protestojnë për të drejtat e tyre. E tha edhe Mondri, po e përsëris dhe unë që 4 qytetarë të Kukësit vazhdojnë të jenë të arrestuar se kanë kërkuar të drejtën e tyre legjitime në një shtet demokratik. Njerëzit që janë të dënuar me vendime të formës së prerë nga Gjykata Supreme, sot shëtisin të lirë, sepse janë njerëzit e qeverisjes, janë vëllezërit apo familjarët e ministrit. Kjo është absurde dhe e papranueshme. Ndërkohë, qytetarë të ndryshëm futen në burg, se akuzohen në forma të ndryshme sipas parimit “*Chi ruba poco va in galera, chi ruba troppo fa carriera*”. Kjo është filozofia e kësaj maxhorance, sepse ligjin nuk e kanë për veten e tyre, prandaj ne nuk duhet të vazhdojmë show-un. Vërtet është ligji i trashëgimisë dhe Flamuri e lidhi bukur kur tha që trashëgimia e tyre është trashëgimia e krimit. Vërtet ne këtu bëjmë debate, por ne jemi edhe gardianët e ligjit, për të parë si vepron dhe si reagon ligji ndaj shtresave dhe ndaj përfaqësuesve të ndryshëm politikë. Kur sot shohim dhe provojmë me fakte që ky ligj është i diferencuar, atëherë pse duhet të vazhdojmë të bëjmë show, ligje shumë të bukura, që janë të përputhshme me *acquis communautaire* dhe gjëra të tjera që janë sipas BE-së? Po, ligjet i kemi bërë dhe sipas BE-së është edhe ligji Antimafia i kërkuar nga institucionet ndërkombëtare, i votuar në vitin 2010, por nuk zbatohet dhe nuk vepron sot. Atëherë pse duhet të vazhdojmë të bëjmë këtë show dhe pse duhet që këta deputetë, të cilët e kanë për detyrë të jenë këtu për të

zbatuar ligjin, të largohen sot? Vërtet unë jam votuar dhe jemi të gjithë deputetë, jemi anëtarë të Komisionit të Edukimit dhe Medies, por unë jam votuar si deputet për të mbrojtur ligjin, për ta zbatuar dhe për të miratuar ligje. Ky është funksioni ynë dhe jo të dalim sot e të themi kemi apo jo rend dite. Nuk ka më rend dite në këtë parlament, se kjo maxhorancë ka humbur kredon morale dhe politike për të qeverisur vendin.

Faleminderit!

Grida Duma – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë të Shqipërisë,

Sot shihni një komision jo të zakonshëm, sepse situata e Shqipërisë nuk është aspak normale. Të gjithë kolegët e PD-së janë këtu për të treguar që normaliteti do të ishte një mëkat. Sikur ne të bëheshim palë dhe të relativizonim gjendjen e Shqipërisë në këtë krizë absolute, në të cilën është, do të ishim ne në gabim. Sigurisht, ka plot qytetarë, të cilët presin miratimin e ligjeve, sepse mendojnë se fatet e tyre varen nga zhvillimi i këtij vendi. Kolegët e PS-së kërkuar 5 minuta pushim, ndërkohë që, në fakt, kanë 5 vjet që jo po pushojnë, por po e shkretojnë këtë vend. Arsyeja pse po e shkretojnë këtë vend është sepse me një kapak pusete ekranesh, që paguhet nga taksat e shqiptarëve, janë duke treguar gënjeshtër, duke mashtruar ndërgjegjet e tyre. Unë e kuptoj fare mirë pse kolegët e PS-së nuk qëndrojnë dot këtu, sepse po t'i bëjmë një thirrje qytetare, humane, jo të gjithë janë njësoj dhe të gjithë e kuptojnë që sot rekuizitë dhe parakusht për zhvillimin e këtij vendi është drejtësia sociale. Pa drejtësi sociale, çdo gjë tjetër është një formular.

Shqiptarët e dinë shumë mirë se ligje në letra të bukura dhe të përafruara me Bashkimin Europian ne kemi shumë; shqiptarët e dinë shumë mirë se problemi me ne është zbatimi i ligjit; shqiptarët e dinë shumë mirë se mund të punosh, mund të studiosh, mund të dalësh i shkëlqyer, por duhet të njohësh dikë për të filluar punë; shqiptarë e dinë shumë mirë se çështja nuk është se sa i aftë je, por se kë njëh.

Sot ne jemi në kulminacionin e shoqërisë shqiptare të krimit. Modeli në këtë vend është të bëhesh kriminel i suksesshëm. Sot nuk e ngre më dorën njeri të thotë se do që të jetë i aftë dhe i ndershëm, por vetëm do që të jetë i suksesshëm dhe të ketë lidhjet e duhura. Nuk është më çështje vetëm e dënimit absolut të Agron Xhafajt. Ky është precedenti, të cilin në qoftë se opozita sot e lejon të kalojë me normalitet, do të kthehet në një model social, shumë herë më të thellë dhe nuk do të kemi më mundësi për ta zgjidhur.

Ne jemi sot këtu për të treguar se normaliteti është një mëkat. Nuk mund të diskutohen më ligje, kur ligjet falsifikohen natën në letra dhe i tregohen parlamentit letra të tjera; kur Kodi i Procedurës Penale shkon në favor të vëllait; kur thuhet se vëllai bën një jetë normale, por, në fakt, ai ka normalizuar vetëm krimin dhe modalitetin e krimit në këtë vend. Nuk mund të jetë normale që të heshtin deputetët e Partisë Socialiste, ndërkohë që duhet të ngihen në këmbë dhe të ndërgjegjësohen dhe të thonë se ky është një fakt që i bën keq Shqipërisë. Nuk është një fakt politik, por është shumë më tepër se politik, është fakti social dhe i ndërgjegjes së brendshme, është fakti i një misioni se ku do të shkojë ky vend me 500 mijë shqiptarë, nga më të mirët, që i kanë ikur. Pse kanë ikur? Kanë ikur, sepse e dinë se nuk kanë më shpresë dhe nuk kanë asnjë shans që ky vëlla të dënohet. Kalohet nga jeta normale, gjendet në Vlorë, nuk gjendet në Vlorë, dhe arrin në kulminacion, që i dënuari të padit. Jemi sot në situatën që askush nuk është më i sigurt. Kjo është Shqipëria në krizë dhe nuk ka më asnjë lloj normaliteti. Shqipëria në krizë kërkon, së pari, drejtësi, më pas mund të flasim për zhvillim.

Pa diskutim, askush nuk mund të na gjykojë më që nuk po e bëjmë dot zhvillimin e Shqipërisë, sepse zhvillimi i Shqipërisë, kur koka është e kapur nga krimi, nuk ka asnjë shans të zbresë nga lart poshtë në rregulla, në ligje, në aplikimin e tyre. Kështu zhvillohet Shqipëria.

Hajdeni të flasim për strategji zhvillimi, por kush do ta aplikojë?! Këta vëllezërit apo kush tjetër?! Cilët kushërinj?! Ata që kanë relativizuar dhe thonë se është më mirë që të ketë kanabis në Shqipëri, se merret 20 mijë lekëshi, se njerëzit vdesin arave dhe fushave dhe nuk e di askush se ku janë, apo ata, të cilët mbrojnë sot krimin familjar dhe shfaqen njëherë me zëdhënës shtypi, njëherë pa ndërgjegje dhe njëherë të mbrojtur nga pushteti politik?! Sot nuk ka më situatë normale për Shqipërinë.

Unë ju falënderoj juve për kryesimin e këtij Kuvendi duke ndjekur qenësinë e ligjeve. Qenësia e ligjeve është kjo: A aplikohen ato? Në qoftë se ato falsifikohen, në qoftë se ato bëhen për dy njerëz, në qoftë se sot në rangun më të lartë të denoncimit të fakteve, të ardhura nga gjykatat italiane, në të disatin rast, ne nuk arrijmë dot të sigurojmë minimumin e funksionit të institucioneve, nuk mund të vazhdojmë me normalitet. Për këtë arsye ne do të vazhdojmë të tregojmë se normaliteti nuk është më i pranueshëm dhe

jemi në një situatë krize. Pra, ose do të ketë një përgjegjësi politike për dorëheqjen e ministrit të Brendshëm, ose nuk do të ketë më normalitet politik.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Shqina!

Po, Kejdi.

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Unë mendoj se për rrjedhën që mori ky komision i sotëm, me kolegët e Partisë Socialiste, është thjesht dhe vetëm reflektim i të gjitha mbledhjeve të komisioneve, jo të ditëve të fundit, por të muajve të fundit që ne kemi pasur, për arsyen e vetme sepse falangat e krimit të kësaj qeverie nuk janë më tani vetëm te droga dhe te korrupsioni qeveritar, por janë shtrirë në çdo aspekt të jetës së shqiptarëve. Ato janë shtrirë tek arsimi, që është në kompetencën e këtij komisioni; janë shtrirë te kultura, që është në kompetencë të këtij komisioni; janë shtrirë te media, që është kompetencë e këtij komisioni. Prandaj, asgjë nga ato që ne duhet të diskutojmë në normalitet, siç e tha edhe zonja Shqina, nuk mund të jenë në normalitet, sepse çdo gjë funksionon me parimet e mafies në këtë vend ku ne po jetojmë.

Ndaj, ne kemi rreth 2 apo 3 javë që themi se nuk mund të diskutohet ligji “Për trashëgiminë kulturore”, sepse kjo qeveri, e cila në konceptin dhe vizionin e saj ka kanabizimin dhe shkatërrimin e vendit, nuk mundet dhe nuk ka se si të mbrojë apo të përpiqet të rijetëzojë trashëgiminë e kulturore të vendit tonë. Kjo qeveri po shkatërron identitetin tonë kombëtar ditën për diell, pa pasur as frikë, as siklet dhe as turp nga qytetarët e saj. Unë sinqerisht kam qenë e shokuar, sepse ka rreth 2 javë që Partia Demokratike denoncon vëllanë e ministrit të Brendshëm, i cili ka një vendim të formës së prerë në Itali, dhe nuk reagon prokuroria, nuk reagon as policia. Madje, ajo që të bën më shumë të qeshësh, është se shikon lart e poshtë njerëz, po aq të përfshirë në strukturat kriminale, që dalin dhe mbrojnë si pa asgjë të keqe.

Dje, kur po flisja me një grup qytetarësh të zonës sime zgjedhore, më bënë një pyetje: nëse kjo qeveri vazhdon e tillë, vallë, a do ta heqë fare pozicionin e ministrit të Brendshëm, sepse duket e pamundur që kjo qeveri të gjejë një njeri, që të jetë ministër i Brendshëm dhe të mos jetë i lidhur me trafikun e drogës? Pra, deri në këtë pikë ka arritur

kjo qeveri dhe deri në këtë pikë po e çon vendin. Ndaj, asgjë tjetër, përveç çështjes parësore, që është largimi i kësaj qeverie, në mënyrë që shqiptarët të shpëtojnë nga krimi, nuk mund të jetë temë diskutimi në këtë komision.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, Kejdi!

Në fakt, kam përshtypjen se kjo qeveri e ka gjetur zgjidhjen, sepse nuk do të vendosë më ministër të Brendshëm të lidhur me trafikantët, por të vendosë një trafikant.

Unë dua ta mbyll këtë mbledhje. Meqenëse ra fjala, këtu kanë thirrur stafin e komisionit dhe e kanë larguar. Kjo nuk është normale, sepse stafi duhet të jetë këtu derisa unë ta mbyll mbledhjen.

Në fund të kësaj mbledhjeje, dua t'u bëj thirrje të gjithë deputetëve të këtij komisioni, një pjesë prej të cilëve i vlerësoj, që të mos bëhen palë me këtë qeveri, e cila është e kapur nga krimi dhe droga, të mos heshtin atëherë kur ligjin e bëjnë bandat dhe kriminelët. Ata që heshtin, do të mbajnë përgjegjësi, sepse po vrasin të ardhmen e familjeve dhe të fëmijëve tanë. Ata do të mbajnë përgjegjësi për heshtjen që bëjnë sot kur ligjet shkelen. Ata do të mbajnë përgjegjësi që nuk kanë folur asnjë fjalë, madje kanë mbrojtur ish-ministrin e Brendshëm, Tahiri, dhe sot heshtin, kur duhet të bërtasin që ministri aktual i Brendshëm të japë dorëheqjen ose t'i kërkojnë Kryeministrit që ta shkarkojë menjëherë.

Faktikisht kjo qeveri ka rënë dhe kjo maxhorancë ka rënë dhe, për aq kohë sa ka rënë, ne nuk mund të rrimë këtu dhe të diskutojmë për një ligj, të cilin ata nesër do ta shkelin me të dyja këmbët.

Faleminderit! Mbledhjen e konsideroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.05.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Milva Ekonomi – nënkryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 2 dhe 7 maj 2018.
2. Vijimi dhe mbyllja e diskutimit nën për nën të projektligjit “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (*komision përgjegjës*). Miratimi në tërësi i projektligjit.

Marrin pjesë:

Milva Ekonomi, Ylli Fideli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Fadil Nasufi, Bujar Çela, Almira Xhembulla, Besnik Baraj (*zëvendësues*), Anduel Xhindi (*zëvendësues*).

Mungojnë:

Albana Vokshi, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Valentina Duka, Romeo Gurakuqi, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Adelina Rista dhe Ismet Beqiraj.

Të ftuar:

Sofjan Jaupaj – këshilltar ligjor i ministres së Kulturës,
Eris Hysi - avokate mbështetëse në Ministrinë e Kulturës,
Ekflooda Leskaj – këshilluese ligjore e Fondacionit Shqiptar-Amerikan për Zhvillim.

HAPET MBLEDHJA

Milva Ekonomi – (*Mungesë incizimi.*)

